

**VENDIM**

**Nr. 10, dt. 08.01.2016**

Në mbështetje të nenit 28 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Rrënojat e Xhamisë” në lagjen Bejleri, Libohovë, Gjirokastrë.
2. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Kulla e Sahatit”, Libohovë, Gjirokastrë si dhe zona e mbrojtur e saj.
3. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit ”Porta e banesës Gogo”, fshati Dhoksat, Gjirokastrë.
4. Miratimin për shpallje monument kulture kategoria e I-rë e objektit “Bendi i Mingulit” në përroin e Mingulit, Gjirokastrë.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**

